

Termet e Referencës: Ekspert për ofrimin e një programi të quajtur "Ditët e shkencës në park"

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përmes Grantit PONT në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare (PA_028), duke ndjekur planin operacional të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar në monitorimin dhe ruajtjen e specieve treguese si një komponent kyç i menaxhimit të përgjithshëm të zonës së mbrojtur së bashku me habitatet kryesore. Për të siguruar efektivitetin e përpjekjeve tona për ruajtje, ne po kërkojmë një ekspert me përvojë për të ofruar një program të quajtur "Ditët e shkencës në park".

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

a. Të realizojë një program të quajtur "Ditët e shkencës në park".

3. Qëllimi

Eksperti do të jetë përgjegjës për: Ofrimin e 12 ditëve të programit të quajtur "Ditët e shkencës në park" në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare, që do të ndihmojë AdZM-të e Shkodrës dhe Kukësit ta zbatojnë atë në të ardhmen si pjesë e programit.

4. Kohëzgjatja

Konsulenca pritet të fillojë më 10 korrik dhe të përfundojë më 1 shtator. Shumica e punës do të kryhet në Shkodër dhe Kukës. Eksperti pritet të ofrojë një program të quajtur "Ditët e shkencës në park", që përmban module trajnimi dhe informacion të sfondit në lidhje me Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare.

5. Reportimi

Eksperti do të dorëzojë një raport mbi aktivitetet tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura së bashku me rekomandimet.

6. Kualifikimi

Kandidati duhet të ketë:

- a. 5 - 10 vite përvojë në fushën e ekspertizës së biodiversitetit dhe ndërgjegjësimit publik
- b. Ekspertizë të dëshmuar në përbërjen e habitatit dhe specieve të Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare
- c. Njohuri me kontekstin ekologjik të zonës së projektit.

7. Buxheti

Buxheti për konsulencën referohet linjave të buxhetit:

- Aktiviteti Nr. 4.1 "Ditët e shkencës në park"

Duke bërë vlerën totale të kësaj konsulence 3000 Euro duke përfshirë 15% të taksave.

8. Procesi i Aplikimit dhe Afati

Procesi i Aplikimit dhe Afati Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV deri më 7 korrik 2024 në adresën info@akzm.gov.al